

| Emri i Lëndës : E Folura në Publik |                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
|------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------|----------------|---------|------|
| Kodi                               | Tipi                                                                                                                                                                                           | Semestri                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Leksione (orë/javë) | Seminare (orë/javë) | Lab (orë/javë) | Kredite | ECTS |
| COM 304                            | C                                                                                                                                                                                              | Pranverë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 3.00                | 0.00                | 0.00           | 3.00    | 6.00 |
|                                    |                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| Lektori                            |                                                                                                                                                                                                | Ramadan Cipuri, Prof. Asoc. Dr.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| Asistenti                          |                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| Gjuha e kursit                     |                                                                                                                                                                                                | Shqip                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                     |                     |                |         |      |
| Niveli i lëndës                    |                                                                                                                                                                                                | Bachelor                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                     |                     |                |         |      |
| Përshkrimi                         |                                                                                                                                                                                                | Gjatë gjithë historisë së njerëzimit njerëzit e kanë përdorur të folurin në publik si një mënyrë vitale komunikimi. Të folurit në publik është një mënyrë e bërjes publike të ideve; e ndarjes së këtyre ideve me njerëzit e tjerë dhe një mënyrë e ndikimit të individëve. Në kurs do të flitet për artin e të folurit në publik dhe do të analizohen të gjithë faktorët që ndikojnë në përgatitjen dhe mbajtjen e një fjalimi të mirë para publikut. Që një komunikim i tillë të jetë efikas, duhen njohur mirë elementet që përfshihen gjatë një ndërveprimi të tillë. Analiza e audiencës, puna kërkimore paraprake, zgjedhja e temës, hartimi i fjalimit në mënyrë të strukturuar, mposhtja e etheve të skenës dhe arti i të bindurit janë disa nga çështjet që do të trajtojmë së bashku. |                     |                     |                |         |      |
| Objektivat                         |                                                                                                                                                                                                | Në fund të kësaj lënde, studenti do të jetë i familjarizuar me paraqitjen e një ligjërate të mirëargumentuar dhe mirëprezantuar, të përshtatshme me situatën përkatëse. Për të bërë këtë, do të përqendrohet në disa aspekte si: Çfarë do të thotë të jesh një folës dhe dëgjues etik i mesazheve? Identifikimi i elementeve qëndrorë për një mesazh logjik dhe të mirëorganizuar; Identifikimi dhe prezantimi i llojeve të ndryshme të ligjëratave etj                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |                     |                     |                |         |      |
| Konceptet Kryesore                 |                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| Programi i Lëndës                  |                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| Java                               | Tema                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 1                                  | Hyrje në artin e të folurit në publik;Tradita e folurit në publik; Ngjashmëritë dhe dallimet midis të folurit në publik dhe bisedimit- Të folurit publik dhe mendimi kritik.                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 2                                  | Analiza e audiencës; Fokusimi te audience; Psikologjia e audiencës; Analiza demografike e audiencës; Analiza e audiencës sipas situatës; Marrja e informacioneve mbi audiencën                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 3                                  | Zgjedhja e një teme dhe qëllimi; Zgjedhja e një teme; Përcaktimi i qëllimit të përgjithshëm dhe specifik; Formulimi i idesë kryesore                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 4                                  | Etika dhe të folurit në publik; Rëndësia e etikës; Këshilla për të folurit etik; Plagjiatura; Këshilla për dëgjimin etik Dëgjimi; Dëgjimi dhe të menduarit kritik; Shkaqet e dëgjimit të dobët |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 5                                  | Mbledhja e materialeve; Përdorimi i njohurive dhe i përvojave vetjake; Kërkimi në bibliotekë; Kërkimi në internet; Intervista; Këshilla për punën kërkimore                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 6                                  | Organizimi i pjesës kryesore të fjalimit- Pikat kryesore- Materialet mbështetëse                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 7                                  | Fillimi dhe fundi i fjalimit; Hyrja; Konkluzioni; Skicimi i fjalimit; Skica e përgatitjes; Skica e mbajtjes së fjalimit                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 8                                  | Përdorimi i gjuhës; Kuptimi i fjalëve; Përdorimi i saktë dhe i qartë i fjalëve; Përdorimi i përshtatëshëm i gjuhës                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 9                                  | Mbajtja e fjalimit; Metodat e mbajtjes së fjalimit; Zëri i folësit; Trupi i folësit                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 10                                 | Përdorimi i mjeteve ndihmëse pamore; Llojet e mjeteve ndihmëse pamore; Përdorimi i Power Point-it                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |
| 11                                 | Llojet e fjalimeve; Të flasësh për të informuar; Të flasësh për të bindur                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                     |                     |                |         |      |

|                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>12</b>                                                                                                                                                                                                                                                            | Metodat e bindjes; Ndërtimi i besueshmërisë; Përdorimi i evidencës; Arsyetimi; Tërheqja emocionale (patosi)                                                                        |
| <b>13</b>                                                                                                                                                                                                                                                            | Fjalimet për raste të veçanta; Fjalime prezantuese; Fjalime dorëzimi të një vlerësimi publik; Fjalime pranimi të një vlerësimi publik; Fjalime përkujtimore; Fjalimet e pasdarkave |
| <b>14</b>                                                                                                                                                                                                                                                            | Fjalimet në grupe të vogla; Çfarë është një grup i vogël?; Udhëheqja dhe përgjësiti në grupe të vogla; Metodat e mendimit reflektues; Prezantimi i mendimeve të grupit             |
| <b>15</b>                                                                                                                                                                                                                                                            | Përsëritje, prezantim i projekteve studentore                                                                                                                                      |
| <b>16</b>                                                                                                                                                                                                                                                            | Provim Final                                                                                                                                                                       |
| <b>Parakushtet</b>                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                    |
| Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                                                                                                    |
| <b>Literatura</b>                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                    |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lucas E., Stephen; Arti i të folurit në publik, UET Press, Tirana, 2011</li> <li>• Vehbiu, Ardian; Shqipja totalitare – Tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990; Botimet Çabej; Tirana 2007</li> </ul> |                                                                                                                                                                                    |
| <b>Referenca të tjera</b>                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                    |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sprague, Jo; Stuart, Douglas; The speaker's compact handbook; Wadsworth Centage Learning, 2010</li> <li>• Public Speaking and presentations; The MC-Graw - Hill Companies; 2010</li> </ul>                                  |                                                                                                                                                                                    |
| <b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b>                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                    |
| <b>1</b>                                                                                                                                                                                                                                                             | Studentët do të përvetësojnë njohuri mbi paraqitjen e një ligjërata të mirëargumentuar dhe mirëprezantuar, të përshtatshme me situatën përkatëse.                                  |
| <b>2</b>                                                                                                                                                                                                                                                             | Studentët do të zhvillojnë mendimin kritik mbi perceptimin e mesazhit të shpërndarë dhe analizimin e audiencës para dhe pas ligjërimit publik                                      |
| <b>3</b>                                                                                                                                                                                                                                                             | Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë elementët qendrorë për një mesazh logjik                                                                                          |

| Mënyra e Vlerësimit të Lëndës                                                            |       |                   |                       |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-------|-------------------|-----------------------|
| Notat e Ndërmjetme                                                                       | Sasia | Përqindja         |                       |
| Gjysmë finale                                                                            | 0     | 0                 |                       |
| Kuize                                                                                    | 0     | 0                 |                       |
| Projekte                                                                                 | 1     | 20                |                       |
| Projekte semestrale                                                                      | 1     | 20                |                       |
| Punë laborator                                                                           | 0     | 0                 |                       |
| Pjesëmarrja në mësim                                                                     | 1     | 20                |                       |
| Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final                                   |       |                   | 60                    |
| Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final                                         |       |                   | 40                    |
| Total                                                                                    |       |                   | 100                   |
| Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)                                        |       |                   |                       |
| Aktivitetet                                                                              | Sasia | Kohëzgjatja (orë) | Ngarkesa Totale (orë) |
| Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit) | 16    | 3                 | 48                    |
| Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)                              | 14    | 2                 | 28                    |
| Detyra                                                                                   | 2     | 30                | 60                    |
| Gjysmë finale                                                                            | 0     | 0                 | 0                     |
| Provimi final                                                                            | 1     | 15                | 15                    |
| Të tjera                                                                                 | 0     | 0                 | 0                     |
| Ngarkesa totale e orëve                                                                  |       |                   | 151                   |
| Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)                                                       |       |                   | 6.04                  |
| ECTS                                                                                     |       |                   | 6.00                  |